



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 maj 2013
Nr. ref.:RK412/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastet Nr. KI105/12 dhe Nr. KI133/12

Parashtrues të kërkesës
Shoqata e Gjuetarëve “Dukagjini” e Klinës
dhe
Federata e Gjuetarëve të Kosovës

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së
Punëve të Brendshme, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Shoqata e Gjuetarëve “Dukagjini”, me seli në Klinë, dhe Federata e Gjuetarëve të Kosovës, të përfaqësuara nga Cenë Gashi dhe nga Rexhep Shkodra.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar i autoritetit publik, me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutën e Kosovës, është Vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Nr. 847/2011, i 14 nëntorit 2011, i cili ka hyrë në fuqi në ditën e nënshkrimit, më 14 nëntor 2011.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011, në bazë të të cilit kartelat WRCU/WRC (ose lejet për regjistrim të armëve, të njohura si armë të gjuetisë ose të rekreacionit), të cilave u vazhdohet afati deri më 1 nëntor 2012, ndryshohen në kartela të Ministrisë së Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejme: MPB).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës; neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe rregulli 37.1 e rregulli 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 22 tetor 2012, parashtruesi i parë i kërkesës, Shoqata e Gjuetarëve “Dukagjini”, me seli në Klinë, parashtoi kërkesë në Gjykatë.
6. Më 5 nëntor 2012, me vendimin GJ. R. KI105/12, Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtar raportues Zëvendëskryetarin Ivan Čukalović, ndërsa, me vendimin KSH KI105/12, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova (anëtare) dhe Kadri Kryeziu (anëtar).
7. Më 5 nëntor 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës (KI105/12) dhe MPB-në për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.
8. Më 22 nëntor 2012, MPB-ja dërgoi komentet e saj përkitazi me kërkesën. Në shkresën e saj, Ministria e Punëve të Brendshme, thotë: “*Ne kemi mbajtur takime të rregullta me Federatën e Gjuetarëve dhe u kemi shpjeguar atyre se ne si MPB nuk mund të zbatojmë kërkesën e tyre për përjashtim nga provimi profesional, sepse Ligji për Armët nuk ka paraparë dispozitë përjashtuese për asnjë kategori të shoqërisë së Kosovës*”.

9. Më 24 dhjetor 2012, parashtruesi i dytë, Federata e Gjuetarëve të Kosovës, parashtroi kërkesë në Gjykatë.
10. Më 26 dhjetor 2012, në pajtim me rregullin 37.1 të Rregullores së punës, Kryetari urdhëroi bashkimin e kërkesave KI105/12 dhe KI133/12, për arsye se kërkesa ishte drejtuar kundër aktit të njëjtë të autoritetit publik. Me këtë urdhër ishte caktuar që Gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të ishte e njëjtë, ashtu siç ishte vendosur me vendimet e Kryetarit, të 5 nëntorit 2012, për caktimin e Gjyqtarit raportues dhe të Kolegjit shqyrtues.
11. Më 22 janar 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin e dytë të kërkesës (KI133/12) dhe MPB-në për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.
12. Më 31 janar 2013, Gjykata i dërgoi parashtruesit të dytë të kërkesës (Federatës së Gjuetarëve të Kosovës) dhe MPB-së kërkesë për informatë shtesë.
13. Në kërkesën e saj për informatë shtesë, të 31 janarit 2013, drejtuar Federatës së Gjuetarëve të Kosovës, Gjykata kërkoi konfirmim se me cilën datë Federata e Gjuetarëve kishte pranuar nga MPB-ja Vendimin Nr. 847/2011, e 14 nëntorit 2011.
14. Në kërkesën e saj për informatë shtesë, të 31 janarit 2013, drejtuar MPB-së, Gjykata kërkoi konfirmim për numrin e shoqatave të gjuetarëve që janë të autorizuar për lëshimin e certifikatave për dhënien me sukses të provimit profesional në kuadër të Vendimit Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011, si dhe kërkoi konfirmim se kur dhe në çfarë mënyre është publikuar vendimi te palët përkatëse.
15. Më 6 shkurt 2013, MPB-ja dërgoi përgjigje në kërkesën e Gjykatës, të 31 janarit 2013, duke sqaruar:

“Sipas Ligjit për Armë (04/L-143) i vetmi autoritet i cili lëshon certifikata për dhënien me sukses të provimit profesional për armë është Ministria e Punëve të Brendshme, gjegjësisht Departamenti për Siguri Publike. Vendimi Nr. 847, i datës 14/11/2011, në pikën 5, ka lënë të hapur mundësinë e diskutimit nga grupet e interesit dhe kjo pikë e vendimit nuk është ekzekutive”.
16. Më 13 shkurt 2013, Federata e Gjuetarëve të Kosovës dërgoi përgjigje në kërkesën e Gjykatës, të 31 janarit 2013, duke njoftuar se Federata e Gjuetarëve ka pranuar me postë elektronike, më 17 nëntor 2011, Vendimin Nr. 847/2011.
17. Më 29 prill 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Më 14 nëntor 2011, MPB-ja miratoi një vendim në bazë të të cilit kartelat WRCU/WRC (ose lejet për regjistrim të armëve, të njohura si armë të gjuetisë ose të rekreacionit), të cilave u vazhdohet afati deri më 1 nëntor 2012, ndryshohen në kartela të MPB-së. Sipas të të njëjtit vendim, Departamenti për

Siguri Publike (në tekstin e mëtejshëm: DSP) i MPB-së i lëshon kartelë me afat njëvjeçar aplikuesit që përmbush një sërë kushtesh, të përcaktuara me nenin 2 të Vendimit Nr. 847/2011. Më tej, sipas Vendimit, nëse brenda afatit njëvjeçar poseduesit e lejeve për regjistrim të armëve (WRC) sjellin edhe certifikatën për dhënien me sukses të provimit profesional, atëherë DSP-ja lëshon kartelë me afat pesë (5) vjet.

19. Sipas parashtruesve të kërkesës, një numër i konsiderueshëm i anëtarëve të Shoqatës së Gjuetarëve "Dukagjini" dhe të Federatës së Gjuetarëve të Kosovës, i ka kryer shumë vite më parë testet praktike dhe teorike, të kërkuara me Vendimin e MPB-së, prandaj ata edhe kanë fituar të drejtën për armë gjuetie.
20. Neni 5, i Vendimit të MPB-së, përcakton: *"Ministria shqyrton mundësinë e përjashtimit nga testi teorik apo testi praktik për poseduesit e lejeve të përmendura në nenin 1 dhe nenin 2 në rast se testi teorik apo praktik mund të dëshmohet me ndonjë certifikatë relevante e lëshuar në procedurë të rregullt nga organet legjitime"*. Parashtruesi i parë i kërkesës (KI105/12) pohon se MPB-ja nuk i ka pranuar certifikatat e lëshuara në procedurë të rregullt, duke obliguar gjuetarët t'i nënshtrohen një testi në klubin e shenjëtarisë "Katana" në Obiliq, sipas parashtruesit i vetmi klub në Republikën e Kosovës, duke obliguar gjuetarët që për test të paguajnë një shumë fikse: 170 euro.
21. Sipas dokumentacionit të paraqitur në kërkesë, përkatësisht në shkresën e parashtruesit të dytë (KI133/12), drejtuar MPB-së më 1 nëntor 2011, bëhet me dije se, në kuadër të regjistrave të 24 (njëzetekatër) shoqatave të gjuetarëve, janë të evidencuara 4.188 (katërmijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) certifikata gjuetarësh të kualifikuar gjatë periudhës 2001-2007 dhe në periudhën para vitit 2001. Parashtruesi i kërkesës (KI133/12), në emër të shoqatave të gjuetarëve, ka kërkuar nga MPB-ja, gjithashtu, lirin e gjuetarëve nga provimi teorik dhe nga provimi praktik për armë, me arsyetimin se gjuetarët janë të pajisur me certifikata të gjuetisë, të lëshuara nga organet legjitime.
22. Parashtruesit e kërkesës deklarojnë se nuk kanë ushtruar ankesë ndaj Vendimit të MPB-së, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011, duke pohuar se nuk kanë pasur të drejtë ankese.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljet kushtetuese

23. Parashtruesi i parë i kërkesës (KI105/12) pohon se Vendimi i MPB-së, në bazë të të cilit të gjithë gjuetarët, pa dallim moshe dhe profesioni, i nënshtrohen testit, është i padrejtë dhe i paligjshëm, për arsye se një numër i konsiderueshëm gjuetarësh janë gjuetarë të sprovuar dhe me pasion dhe se e kanë ushtruar këtë sport për më shumë se tridhjetë (30) vjet, dhe të njëjtit kanë kryer shërbimin e rregullt ushtarak, duke u trajnuar për përdorimin e armës dhe, gjithashtu, posedojnë certifikatat e lëshuara nga Federata e Gjuetarëve të Kosovës nëpërmjet një komisioni legjitim. Parashtruesi i parë i kërkesës më tej shpjegon se, në strukturën e gjuetarëve, është një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, i pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës, të cilët, në kuadër të profesionit të tyre, janë trajnuar për përdorimin e armëve, duke pretenduar se është e padrejtë, e pajustificueshme, e kundërligjshme dhe

kundërkushtetuese që këto kategori të gjuetarëve t'i nënshtrohen testit të kërkuar në bazë të Vendimit të MPB-së, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011.

24. Parashtruesi i parë i kërkesës (KI105/12) pohon se, me Vendimin e MPB-së, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011, janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës: neni 3 i Kushtetutës [Barazia para Ligjit]; neni 21 [Parimet e Përgjithshme]; neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; neni 24 [Barazia para Ligjit]; neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; neni 44 [Liria e Asociimit]; neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; neni 55 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore].
25. Parashtruesi i dytë i kërkesës (KI133/12) pohon se, me Vendimin e MPB-së, Nr. 847/2011, të 14 nëntorit 2011, janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës: neni 3 [Barazia para Ligjit]; neni 16 [Epërsia e Kushtetutës]; neni 17 [Marrëveshjet Ndërkombëtare]; neni 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare]; neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare]; neni 21 [Parimet e Përgjithshme]; neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; neni 24 [Barazia para Ligjit]; neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; neni 44 [Liria e Asociimit]; neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]; neni 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore].
26. Parashtruesi i dytë i kërkesës (KI133/12) më tej pohon se, Vendimi i MPB-së, Nr. 847/2011, i 14 nëntorit 2011, është në kundërshtim me dispozitat e nenit 1 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, Nr. 02/L-42; me dispozitat e nenit 47 (Ligji për Gjuetinë, Gazeta Zyrtare e KSAK, Nr. 37, i 25 shtatorit 1979, KK Nr. 112-57/79); me dispozitat e nenit 63 të Ligjit për Gjuetinë, Nr. 02/L-53, të 16 dhjetorit 2005; dhe me dispozitat e nenit 7 të Ligjit për Armët, Nr. 03/L-143, të 17 nëntorit 2009.
27. Parashtruesit e kërkesës, në kërkesën e tyre, në emër të të gjithë gjuetarëve të kualifikuar, me anëtarësi në shoqatat e gjuetarëve, kërkojnë shqyrtimin e ligjshmërisë dhe të kushtetutshmërisë së vendimit të organeve kompetente të MPB-së për mosnjohje të kualifikimeve ligjore të gjuetarëve për armë dhe për gjueti, deri në vitin 2007.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesve, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen me Kushtetutë dhe që saktësohen me Ligj dhe me Rregullore të punës.
29. Sa i përket kërkesës së parashtruesve, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

30. Për të vërtetuar faktin nëse parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën brenda afatit të përcaktuar katërmuajsh, Gjykata i referohet kohës së pranimit të vendimit të fundit nga parashtruesit e kërkesës si dhe datës së paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.
31. Nga parashtruesat shihet që kërkesat në Gjykatën Kushtetuese janë parashtruar më 22 tetor 2012 dhe më 24 dhjetor 2012, ndërkohë që Vendimi i MPB-së, Nr. 847/2011, i 14 nëntorit 2011, i është komunikuar Federatës së Gjuetarëve të Kosovës me postë elektronike më 17 nëntor 2011, që do të thotë se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.
32. Bazuar në atë që u tha më sipër, rezulton se kërkesa është e paafatshme.
33. Prandaj, kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme, për shkak të mosrespektimit të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës; në përputhshmëri me nenin 49 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.1 (b) të Rregullores, më 24 maj 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

